
OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQENDRUARA SH.A**Data: 30.07.2026****PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra****PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM***(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

OBJEKTI I PROCEDURËS: Blerje pajisje informatike, për KLSH për vitin 2026”, për nevojat e autoritetit kontraktor Kontrolli i Lartë i Shtetit, e ndarë në lote si më poshtë:

Emërtimi i lotit
Loti 1 - Furnizim-vendosje e pajisjes firewall
Loti 2 - Furnizim-vendosje e pajisjes storage server
Loti 3 - Furnizim-vendosje pajisje kompjuterike

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP):*Kompjuter portativ 30213100-6**Kompjuter desktop 30213300-8**Komponentë të rrjetit 32422000-7**Servera kompjuterikë 48822000-6*

VLERA E FONDIT LIMIT: 12,457,433 (dymbëdhjetë milionë e katërqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH, për lotet si më poshtë:

Emërtimi i lotit	Vlera e parashikuar e prokurimit / lot (lekë pa TVSH)	Vlera e shkruar me fjalë
Loti 1 - Furnizim-vendosje e pajisjes firewall	2,343,933.00	Dy milionë e treqind e dyzet e tre mijë e nëntëqind e tridhjetë e tre
Loti 2 - Furnizim-vendosje e pajisjes storage server	3,111,200.00	Tre milionë e njëqind e njëmbëdhjetë mijë e dyqind
Loti 3 - Furnizim-vendosje pajisje kompjuterike	7,002,300.00	Shtatë milionë e dy mijë e treqind

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (të ndryshuar) nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Autoriteti Kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara në

rolin e Organit Qëndror Blerës, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

TË NJËJTA PËR TË GJITHA LOTET

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 26, nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Neni 82, i LPP përcakton se *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”*. Neni 83 i LPP përcakton se *“Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”*,

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 39% e vlerës së përlllogaritur për secilin prej loteve / shumatores së loteve për të cilat konkurron**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 43 pika 2/b të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: *“Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”*. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: *“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”* dhe në pikën 3 të tij përcaktohet se: *“3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.”*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: **Vlera e kërkuar jo më e vogël se 39% e vlerës e fondit limit të objektit që prokurohet**, është në përputhje me përcaktimet në nenin 43 pika 2/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë : b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;”*.

Në rastin konkret Njësia e Prokurimit ka konsideruar te arsyeshme që vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **39% e vlerës e fondit limit të objektit që prokurohet**, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, nxitjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë si edhe të sigurimit të një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë ofertuesit e mundshëm ekonomikë. Marrë shkas nga fakti që referuar përcaktimit të bërë në nenin 43 pika 2/b, Autoriteti Kontraktor nuk mund të tejkalojë vlerën e përlllogaritur të fondit limit në kërkesën për kualifikim, por në respektim të parimeve ligjore dhe në përmbushjen e qëllimeve të ligjit të prokurimit si më sipër cituar ka

tagrin të kërkojë një vlerë më të ulët se fondi i përlogaritur i kontrates. Kjo vlerë është kërkuar duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, vlerën e fondit limit, me qëllim që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 19% e vlerës së fondit limit për secilin prej loteve / shumatores së loteve për të cilat konkurron**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara
- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 1 dhe 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar neni 40 pika 3 dhe 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.” dhe në pikën 4 të tij përcaktohet se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

Në nenin 40 pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar përcaktohet se: “3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të

gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.” dhe në pikën 4 të tij përcaktohet se:

“Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e ngjashme cka duhet të vërtetohen nëpërmjet dokumenteve si më sipër kërkuar. Një operator ekonomik i cili ka realizuar më parë kontrata të ngjashme me objektin e prokurimit, i krijon bindjen dhe besueshmërinë te Autoritetit Kontraktor, se ai ka aftësi organizative, personelin e nevojshme dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie të kërkuar në dokumentet e tenderit.

Furnizimet e mëparshme të ngjashme janë kërkuar në vlerën jo më pak se në vlerën jo më pak se 20 % e vlerës së fondit limit. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatën **ISO 9001:2015 “Mbi Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë” / ose ekuivalent** (të vlefshme në datën e zhvillimit të tenderit), në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
3. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatën **ISO 27001:2022 “Mbi Sistemet e Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit” / ose ekuivalent** (të vlefshme në datën e zhvillimit të tenderit), në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesat 2, 3 të mësipërme janë vendosur në përputhje me nenin 79 "Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor" të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojnë ofertuesve të paraqesin certifikatat të lëshuara nga një organ i

vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.” Ky kriter gjen mbështetje gjithashtu në piken 1 të nenit 44 "Kërkesat e cilësisë "të VKM nr.285 date 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar, ku përcaktohet se: "1. "Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe nëmënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit". Sa më sipër, ky kriter shërben për njohjen e kapacitetit të operatorëve ekonomikë ofertues dhe aftësinë e tyre teknike dhe profesionale për të furnizuar artikuj cilësorë dhe që janë prodhuar / vendosur në treg sipas standardit të sipërpërmendur. ISO 9001 përcakton kërkesat për një sistem menaxherial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të certifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. (e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilin AK kërkon të kryhet me cilësi dhe në kohë). Duke parë objektin e prokurimit, autoriteti kontraktor vlerëson të nevojshme të kërkojë që operatorët ekonomikë ofertues të jenë të pajisur me certifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, me qëllim që furnizimet të kryhen me cilësi sipas certifikatës ISO të mësipërme.

Kërkesa për paraqitjen e certifikatës **ISO 27001:2022** ose ekuivalente është vendosur për të garantuar që operatori ekonomik disponon një **Sistem të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (Information Security Management System – ISMS)** të implementuar dhe të certifikuar sipas një standardi ndërkombëtar të njohur. Ky standard siguron që operatori ka procese të dokumentuara dhe mekanizma të kontrollit për identifikimin, vlerësimin dhe trajtimin e rreziqeve që lidhen me sigurinë e informacionit, duke garantuar konfidencialitetin, integritetin dhe disponueshmërinë e informacionit gjatë realizimit të kontratës.

Duke qenë se objekti i prokurimit përfshin përpunimin, administrimin, ruajtjen, transmetimin ose aksesin në sisteme dhe të dhëna elektronike, është e domosdoshme që operatori ekonomik të demonstrojë se zotëron kapacitetet organizative dhe procedurale për të mbrojtur informacionin nga akseset e paautorizuara, humbja, ndryshimi ose komprometimi i tij. Certifikimi sipas **ISO 27001:2022** ofron garanci se këto procese janë verifikuar nga një organ i pavarur certifikues dhe monitorohen në mënyrë periodike.

Kjo kërkesë është në përputhje me parimet e proporcionalitetit dhe lidhet drejtpërdrejt me objektin e kontratës, pasi synon të minimizojë rreziqet e sigurisë së informacionit gjatë ekzekutimit të saj dhe të sigurojë besueshmërinë e operatorit ekonomik në menaxhimin e informacionit dhe asetëve të lidhura me teknologjinë e informacionit.

4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi i mallrave ose nga distributori i autorizuar nga prodhuesi, ku në rast se dokumentohet lidhja e distributorit me prodhuesin, për lejimin e tregimit të artikujve të tij.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 77 pika 1 dhe 4 të ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar parashikohet se: "1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe

profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

Në neni 40/3/ 8 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” i VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar “3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.” dhe në pikën 8 përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Ky kriter është i lidhur ngushtë me objektin e prokurimit si dhe me aftësinë zbatuese të kontratës, me garantimin e kapaciteteve profesionale dhe të cilësisë nga operatori ekonomik pjesëmarrës. Autorizimi i prodhuesit/ ose distributorit të autorizuar duhet të paraqitet nga operatori ekonomik, pasi vërteton që prodhuesi/ distributor i autorizuar, autorizojnë operatorin ekonomik të tregtojë produktin e tij në Republikën së Shqipërisë. Me anë të këtij kriteri operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka të drejtat ligjore nga prodhuesi për të ofertuar mallin e kërkuar, origjinalë të prodhuara nga prodhuesi. Në rast se ofertuesi e ka marrë të drejtën për të ofertuar mallin e kërkuar nga distributori i autorizuar nga prodhuesi atëherë, ofertuesi duhet të vërtetojë lidhjen midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit. Synimi i kësaj kërkesë për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit është garantimi që ofertuesi ka aftësi të mjaftueshme për të realizuar me sukses dhe cilësi kontratën me autoritetin kontraktor, duke furnizuar mallin objekt prokurimi në cilësi dhe kohë.

5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë teknikë / skeda teknike për artikujt e ofertuar ku të jenë të pasqyruara specifikimet teknike të kërkuara. (Katalogët / skedat teknike duhet të ngarkohen në www.app.gov.al së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DT).

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 77 pika 1 dhe 4 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një

kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.” dhe në nenin 40 pika 6/b të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. ku përcaktohet se: “6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: b) fotografitë apo katalogët teknikë;”. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që të verifikohet përputhshmëria e specifikimeve teknike, duke garantuar që produktet e ofruara i përmbushin të gjitha kërkesat teknike, funksionale dhe standartet e përcaktuara në specifikimet teknike në dokumentat e tenderit.

Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi, i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar mallrat e kërkuar, si dhe për të krahasuar pajtueshmërinë e specifikimeve teknike dhe standartet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor në dokumentet e tenderit, me specifikimet teknike të mallrave të ofruara nga operatori ekonomik. Nisur nga lloji i mallit që kërkohet dhe specifikimet teknike të kërkuara, është e nevojshme që autoriteti kontraktor të sigurohet për mallrat që i ofrohen nga operatorët ekonomik pjesmarrës të vërtetuar nëpërmjet dokumenteve si katalog/ skedë të teknike. Gjithashtu katalogët/skedat teknike do të shërbejnë edhe për marrjen në dorëzim të mallit nga Autoriteti Kontraktor përfitues.

6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë, në të cilën garantohet se pajisjet e ofertuara do të jenë të reja (Jo Refurbished).

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Kërkesa që operatori ekonomik të paraqesë një deklaratë, me anë të së cilës garanton se pajisjet e ofertuara do të jenë të reja (Jo Refurbished), është vendosur për të garantuar furnizimin me pajisje të cilat nuk kanë qenë më parë në përdorim, nuk janë rikondicionuar dhe nuk janë riparuar apo rigjeneruar për t’u rishitur.

Duke qenë se objekti i prokurimit përfshin furnizimin me Firewall, Storage Server, Laptop dhe PC All-in-One, është e nevojshme që të gjitha pajisjet të jenë të reja, me komponentë origjinalë të prodhuesit, në mënyrë që të sigurohet performanca optimale, besueshmëria në funksionim, jetëgjatësia e pritshme dhe mbështetja e plotë nga prodhuesi gjatë periudhës së garancisë.

Pajisjet Refurbished mund të kenë qenë më parë në përdorim ose të kenë kaluar procese riparimi apo zëvendësimi komponentësh, gjë që mund të ndikojë në jetëgjatësinë, performancën, besueshmërinë dhe mundësinë e përfitimit të mbështetjes teknike ose përditësimeve të plota nga prodhuesi. Për pajisje kritike si Firewall dhe Storage Server, përdorimi i pajisjeve të

rikondicionuara mund të rrisë rrezikun e ndërprerjeve të shërbimit dhe të cenojë vazhdimësinë e funksionimit të infrastrukturës së teknologjisë së informacionit.

Kjo kërkesë është në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe lidhet drejtpërdrejt me objektin e prokurimit, pasi synon të garantojë që Autoriteti Kontraktor do të pajiset me produkte të reja, me cikël të plotë jetese, të mbuluara nga garancia e prodhuesit dhe të afta të ofrojnë performancën dhe besueshmërinë e kërkuar gjatë gjithë periudhës së përdorimit. Deklarata përbën një garanci të angazhimit të operatorit ekonomik për respektimin e kësaj kërkesë dhe lehtëson verifikimin e saj gjatë fazës së dorëzimit të mallrave.

7. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë, ku të garantojë se do të kryejë furnizimin, transportin, instalimin dhe konfigurimin bazë të pajisjeve, në përputhje me specifikimet teknike.

Argumentim: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.*

Kërkesa që operatori ekonomik të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës garanton se do të kryejë furnizimin, transportin, instalimin dhe konfigurimin bazë të pajisjeve është vendosur për të siguruar ekzekutimin e plotë dhe funksional të kontratës, në përputhje me objektin e prokurimit.

Objekti i kontratës përfshin furnizimin me pajisje të teknologjisë së informacionit, konkretisht Firewall, Storage Server, Laptop dhe PC All-in-One, të cilat për të qenë të përdorshme kërkojnë jo vetëm dorëzimin fizik, por edhe instalimin dhe konfigurimin bazë sipas specifikimeve teknike të autoritetit kontraktor. Në veçanti, pajisje si Firewall dhe Storage Server kërkojnë konfigurime fillestare për vënien në punë, ndërsa laptopët dhe kompjuterët duhet të instalohen dhe të verifikohet funksionimi i tyre përpara marrjes në dorëzim.

Kjo kërkesë synon të sigurojë që operatori ekonomik disponon kapacitetin teknik dhe organizativ për të realizuar të gjitha fazat e ekzekutimit të kontratës, duke përfshirë transportin e sigurt të pajisjeve, instalimin në ambientet e autoritetit kontraktor, konfigurimin bazë dhe dorëzimin e tyre në gjendje funksionale. Në këtë mënyrë minimizohen rreziqet që lidhen me vonesat, dëmtimet gjatë transportit ose mosfunksionimin e pajisjeve për shkak të instalimit apo konfigurimit të papërshtatshëm.

Kërkesa është në përputhje me parimin e proporcionalitetit, pasi deklarata nuk vendos kufizime të panevojshme për pjesëmarrjen në procedurë, por shërben si garanci e angazhimit të operatorit ekonomik për të realizuar të gjitha detyrimet që burojnë nga objekti i kontratës dhe lidhet drejtpërdrejt me natyrën e furnizimit që do të prokurohet.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Specifikimet teknike të përgjithshme (të aplikueshme për të gjithë lotet):

Detyrimet e operatorit ekonomik

Operatori ekonomik, brenda çmimit të ofertuar, duhet të marrë përsipër:

1. Furnizimin, transportin, instalimin dhe konfigurimin bazë të pajisjeve;
2. Dorëzimin e pajisjeve të reja, të papërdorura dhe në paketim origjinal;
3. Dorëzimin e dokumentacionit teknik dhe garancive;
4. Testimin dhe verifikimin e funksionalitetit të pajisjeve;
5. Mbështetjen bazë teknike gjatë procesit të instalimit dhe dorëzimit.

Dokumentacioni që duhet të dorëzohet

Operatori ekonomik duhet të dorëzojë:

1. Faturat dhe dokumentacionin përkatës të origjinës;
2. Certifikatat e garancisë;
3. Manualët teknike të pajisjeve;
4. Numrat serialë të pajisjeve;
5. Çdo dokument tjetër që vërteton autenticitetin dhe konformitetin e pajisjeve.

Specifikimet teknike të posaçme për secilin lot:

LOTI 1 - FURNIZIM-VENDOSJE E PAJISJES FIREWALL

Kategoria	Specifikimi Minimal
Throughput Firewall	≥ 10 Gbps
Throughput IPS	≥ 4 Gbps
Throughput VPN	≥ 2 Gbps
Porta	$\geq 12x$ GE RJ45 + $\geq 8x$ SFP/SFP+
VPN	IPSec + SSL VPN + ZeroTrust network access
Funksionalitete	L3-L7 Firewall, IPS/IDS, App Control, Web Filtering, NAC 802.1, SSL Inspection
Threat Protection	Anti-malware, anti-bot, sandbox (ose ekuivalent)
NAT	Static, Dynamic, PAT
VLAN	802.1Q, VXLAN
High Availability	Active/Passive; optional hardware + virtual machine combination
Menaxhimi	GUI + CLI
Logging	Syslog + SIEM integration
Autentikimi	Local, AD/LDAP + MFA
Përditësime	≥ 3 vjet, automatike (firmware, signatures, funksionet etj.)
Form Factor	Appliance hardware rack 19"
End of Life	≥ 5 vjet
End of support life	≥ 5 vjet
Optional	Central Management, e-mail filtering,

Kategoria	Specifikimi Minimal
Nr. endpoint	≥ 300
Power	230 VAC (dual), kablllo C13-C14
Garancia	≥ 3 vjet + licenca sigurie (subscription)

LOTI 2 - FURNIZIM-VENDOSJE E PAJISJES STORAGE SERVER

Kategoria	Specifikimi Minimal
Kapaciteti	≥ 20 TB usable RAID 6, i zgjerueshëm ≥ 80 TB
Disk Subsystem	Min. 12 disqe hot-swap, SAS
Tip Disqesh	12Gb SAS: 10K RPM 2.5" Enterprise ose 7.2K RPM 3.5" Enterprise ose ekuivalent
RAID	0,1,5,6,10 me controller hardware, cache ≥ 4 GB (with powered backup)
End of life	≥ 5 vjet
End of support	≥ 5 vjet
Ndërfaqet	$\geq 2x$ 1/10Gbase-T iSCSI + $\geq 2x$ SAS 12Gb per cdo kontrollor
Menaxhimi	'Out-of-band': IPMI/iDRAC/iLO/remote console local/web interface
Backup Features	Snapshot, deduplication, compression, replication, cloud export
Kompatibilitet	Veeam, Backup Exec , Hyper-V, Windows Server, VMware etj.
Performanca	Vlerat tipike ne RAID 6 sipas rastit: Fibre Channel 16G dhe disqe SSD: $\geq 12k$ GB/s sequential reads and $\geq 200k$ IOPSs random reads iSCSI 10G dhe disqe HDD: $\geq 4k$ GB/s sequential reads and $\geq 15k$ IOPSs random reads
Redundanca	PSU redundant + fans redundant + controller redundant
Form Factor	Rackmount 19"

Kategoria	Specifikimi Minimal
Power	230 VAC (dual), kablllo C13-C14
Garancia	≥ 3 vjet Next Bussiness Day

LOTI 3 - FURNIZIM-VENDOSJE PAJISJE KOMPJUTERIKE

Nr.	Emërtimi	Njësia
1	Laptop Basic	Copë
2	PC AIO 23"	Copë

1. Laptop basic

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
Pikët Min. për Procesorin sipas: cpubenchmark.net Min Proc. Rating According to: cpubenchmark.net:	5500 Pikë
“Chipset”:	Intel ose Ekuivalent
“RAM”:	8 GB, DDR4 min. 2133 MHz, Non-ECC
Madhësia e Solid-state Drive “SSD Size”:	256 GB SSD
“Graphics”:	Integrated Graphics with 1 GB Video Memory
Ekrani “Display”:	15.6” LED FHD (1920 x 1080), Anti Glare
Bateria “Battery”:	Min. 45 Wh
KOMUNIKIMI & MENAXHIMI	
Portat e Komunikimit “Ports”:	Min. (3) porta USB nga të cilat min. (2) USB 3.0 (1) DisplayPort/HDMI (1) Integrated Mic. (1) Integrated HD Web Camera (1/1) Headphone/Microphone Jack ose (1) Combo Jack
Rrjeti “Networking”:	10/100/1000 Mbps LAN (RJ-45); Wireless 802.11ac (Kompatibël me 802.11 b/g/n); Bluetooth min. V4.0
“Sound”:	Integrated , (2) x built-in speakers (stereo)
Sistemi i Operimit “Preinstalled Licensed O.S.”:	OEM Windows 11 64-bit Professional
Tastiera “Keyboard”:	QWERTY
“Pointing Device”:	Touch Pad
Siguria “Security Management”:	Embedded Security TPM 2.0
AKSESORËT	
Kabëll “Power Cord”:	Po, European
Ushqyesi “Recharger”:	Po
“Mouse”:	Po, i të njëjtës Markë me Laptopin
Çanta “Carrying Bag”:	Po, nga Prodhuesi. E përshtatshme për Laptop dhe Aksesorët e tjerë.
“Recover”:	Recover Partition
GARANCIA	
Periudha e Mbulimit të Garancisë “Warranty”:	3 Vjet

2. PC AIO 23”

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
Pikët Min. për Procesorin sipas: cpubenchmark.net Min Proc. Rating According to: cpubenchmark.net:	7400 Pikë
"Chipset":	Intel ose Ekuivalent
"RAM":	8 GB, min. DDR4 2666 MHz
Madhësia e Solid-state Drive "SSD Size":	256 GB SSD
"Graphics":	Integrated HD Graphics
"Media Device":	DVD+/-RW Internal ose External e të njëjtës markë me pajisjen
"Slots":	Min. (1) Mini PCI slots/M.2 ose Ekuivalente
Ekrani "Display":	23" Min. FHD (1920x1080) LED Backlight, Anti-Glare
"Web Camera":	Min. HD Camera
"Speakers":	Internal Stereo Speakers
Ushqimi "Power Supply":	220 V AC, 50 Hz
KOMUNIKIMI & MENAXHIMI	
Portat e Komunikimit "Ports":	Min. (5) USB nga të cilat min. (2) USB 3.0; (1) RJ-45; (1) DP/HDMI Min. (1/1) Headphone/Microphone Jack ose (1) Combo Jack; (1) Integrated Mic.;
Rrjeti "Networking":	10/100/1000 Mbps LAN (RJ-45); Wireless 802.11ac (Kompatibël me 802.11b/g/n); Bluetooth min. V4.1
Sistemi i Operimit "Preinstalled Licensed O. S.":	OEM Windows 11 64-bit Professional
Tastiera "Keyboard":	Standart Keyboard QWERTY, Wireless ose Bluetooth
"Pointing Device":	Standart Optical Mouse, Wireless ose Bluetooth
Siguria "Security":	Embedded Security TPM 2.0
AKSESORËT	
Kabëll "Power Cord":	Po, European
"Recover":	Recover Partition
Të tjera:	Energy Star
GARANCIA	
Periudha e Mbulimit të Garancisë "Warranty":	3 Vjet

Shënim për të gjithë lotet: Për çdo certifikatë, standard, markë, emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës të përmendur më lart, pranohet edhe ekuivalenti i tyre.

Argumentimi: *Specifikimet teknike, për mallrin objekt prokurimi, plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).*

Specifikimet teknike sipas DST janë hartuar nga grupi i punës i ngritur nga Titullari i Autoritetit Kontraktor përfitues Kontrolli i Lartë i Shtetit, në përputhje me ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Specifikimet teknike kanë përcaktuar të dhënat minimale teknike sa u takon përmasave fizike dhe materialit përbërës, me qëllim ofrimin e një shërbimi mjekësor sa më optimal për pacientin. Grupi i punës pranë AK përfitues thekson se qëllimi i këtij prokurimi është: i. Upgrade i sigurisë së infrastrukturës së rrjetit; ii. Rritja e kapaciteteve të ruajtjes së të dhënave; iii. Rinovimi dhe standardizimi i pajisjeve të punës për stafin.

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialistët anëtarë të njësisë së prokurimit, bazuar në nevojat e autoritetit kontraktor përfitues.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

NJËSIA E PROKURIMIT